

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Mr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Isa Shala e Gani Avdiu anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses Xh.H. nga Gllgovci, e përfaqësuar nga I.D., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gllgovcit e përfaqësuar sipas autorizimit nga H.H., avokat publik në komunë, me pjesëmarrjen e palës së tretë H.Z. nga Gllgovci, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gllgovc, C.nr. 292/2009 të dt. 27.12.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 07.03.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditurës Komuna e Gllgovcit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gllgovc, C.nr. 292/2009 i dt. 27.12.2012, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Rrethanat e çështjes:

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I. të dispozitivit, është aprovuar padia e Xh.H. kundër Komunës së Gllgovcit për të paguar kompensim në para për dëmet materiale për lokalin afarist të shkatërruar më 1-2 mars 2015 në Gllgovc, Rr. "...", i ndërtuar në ngastrën ..., në vendin e quajtur ..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 71,40 m² në dy kate, dhe komuna e Gllgovcit është obliguar t'ia paguajë kompensimin Xh.H. prej 19.397 € për dëmet materiale, së bashku me normën e interesit nga 01.03.2005. Në pikën II., të dispozitivit është aprovuar pjesërisht padia e Xh.H. kundër Komunës së Gllgovcit për të paguar kompensim në para për dëmet materiale për lokalin afarist të shkatërruar më 1-2 mars 2005 në Gllgovc, Rr. "...", i ndërtuar në ngastrën ..., në vendin e quajtur ..., me sipërfaqen e përgjithshme prej 71,40 m² në dy kate, dhe Komuna e Gllgovcit është e obliguar t'ia paguajë kompensimin Xh.H. prej 10.290€ për dëmet materiale, së bashku me normën e interesit, nga 01.03.2005 ndërsa kërkesa për shumën e mësipërme të kërkuar deri në 19.397€ është refuzuar si e pa bazë. Në pikën III., të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar padia e Xh.H. kundër Komunës së Gllgovcit për të paguar kompensim në para për fitimin e humbur nga dy objektet afariste të shkatërruar në vlerë prej 250€ deri më tani së bashku me kamatën mbi këtë shumë. Në pikën IV., të dispozitivit Komuna e Gllgovcit është e detyruar ta kompensojë Xh.H. me shumën prej 2054€ për shpenzimet gjyqësore. Në pikën V., të dispozitivit, Komuna e Gllgovcit është e detyruar ti paguajë obligimet monetare sipas pikave 1,2 dhe 4 brenda 15 ditëve pasi ky vendim të merr formën e prerë. Në pikën VI., ky aktgjykim është lëshuar pas pjesëmarrjes së palës H.Z. nga Gllgovci në procedurat gjyqësore dhe për këtë arsye ai i detyrohet këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta anulon pikën një, dy dhe katër të dispozitivit të aktgjykimit ankimor duke hedhë poshtë kërkesëpadinë apo të kthejë çështjen në rigjykim në shkallë të parë.

Pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta refuzojë ankesën e të paditurës si të pa bazuar dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogvc, ta vërtetojë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Kompetenca e Gjykatës së Apelit

Kolegji duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave të lëndës vlerësoi se është kompetent për procedim dhe vendim marrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet 17.1, 18.1 dhe 19.1 të Ligjit për Gjykatat i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-199 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 79/2010”)

Vlerësimi formal i ankesës

Nga shkresat e lëndës (fletë kthesa mbi dorëzimin e aktgjykimit si dhe vula e pranimit në kopjen e ankesës) rezulton se ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë është paraqitur brenda afatit ligjor, ajo përmban elementet e parapara me ligj, si dhe është paraqitur për shkaqet për të cilat mund të goditet aktgjykimi i shkallës së parë. Kolegji vlerëson se ankesa i përmbushë kërkesat ligjore nga neni 176, 178 dhe 181 të LPK dhe përfaqëson mjet të rregullt juridik për shqyrtimin e themelësisë së saj.

Ekzaminimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në vitin 1993 Komuna e Glllogvcit përmes një vendimi të Këshillit Komunal të datës 09.12.1993 ia kishte dhënë paditëses Xh.H. një ngastër të tokës për shfrytëzim të përhershëm në një vend të quajtur ... në rrugën “...” lokacioni nr...., në Komunën e Glllogvcit me një sipërfaqe prej

34,30 m² nën detyrimin për të ndërtuar një dyqan në ngastrën në fjalë. Më 23.04.1996 Komuna gjithashtu ia dha lejen për shfrytëzimin e objektit të ndërtuar nga paditësja në ngastër. Sipas këtij vendimi objekti afarist kishte në sipërfaqe të përgjithshme prej 34,30 m², një objekt dykatësh. Ky dyqan ishte shfrytëzuar për qëllime afariste gjatë disa viteve.

Me një vendim të datës 09.12.1993, Këshilli Komunal i Gllgovcit ia dha H.Z. një ngastër të tokës për shfrytëzim të përhershëm në një vend të quajtur ... në rrugën “...” lokacioni nr...., në Komunën e Gllgovcit me një sipërfaqe prej 34,30 m², nën detyrim për të ndërtuar një dyqan në ngastrën në fjalë . Më 4.4.1996 ajo gjithashtu i dha leje për shfrytëzimin e objektit të ndërtuar nga H.Z. në ngastrën. Sipas këtij vendimi objekti afarist ishte në sipërfaqe të përgjithshme prej 34,30 m², një objekt dykatësh.

Parcelat ... ishin afër njëra tjetrës. Objektet ishin ndërtuar nga një kompani ndërtimi që e kishin angazhuar të dy bashkë. Paditësja dhe H.Z.. Ato i ndante vetëm një mur në mes.

Me 18.2.1995 H.Z. nënshkroi një kontratë transaksioni me paditësen për blerjen e dyqanit në parcelën ... për një çmim prej 38.000 DM. Kjo kontratë nuk ishte vërtetuar në gjykatë.

Paditësja paraqiti një kontratë qiraje të lidhur në mes të saj, si qiradhënëse dhe A.G., nga Prishtina, si qiramarrës për dhënie me qira të dy dyqaneve në ngastra ... dhe ... për një qira mujore prej 250 €, për secilin dyqan ose gjithsej 500 €. Kontrata ishte lidhur për periudhën 01.03.2004 deri me 04.03.2007. Shënohet se kontrata ka hyrë në fuqi më 01.03.2004. Paditësja nuk paraqiti prova nëse qiraja ishte paguar (siç kërkohet nga Gjykata). Pala e paditur i kundërshton pretendimet se dy dyqanet iu ishin dhënë me qira A.G.. Sipas avokatit Publik Komunal Z. Hasi, të dy objektet ishin shfrytëzuar nga Kompania “...” dhe Kompania ...2 Kjo deklaratë është në përputhje me fotot e dy dyqaneve të fotografuara vetëm para datës 01.02.2005, të paraqitur nga paditësja. Në njërin prej dyqaneve aty është logoja e Kompanisë “...”. Me aktvendimin e datës 15.02.2005, Komuna e Gllgovcit, Departamenti i inspektimit ia ndaloi përkohësisht kompanisë “...” që të kryej ndonjë veprimtari në objekt derisa kompania të merr leje pune për kryerjen e aktivitetit afarist. Vendimi i njëjtit ishte lëshuar edhe për kompania ...2 Vendimet nuk tregonin se në cilin objekt afarist dy kompanitë i ushtronin aktivitetet e tyre afariste.

Me 26.02.2006, radioja lokale njoftoi se objektet afariste në sheshin e qytetit do të rrënohen nga Komuna.

Paditësja mori masa për të siguruar provat dhe me 28.02.2005, një ekspert me emrin Jakup Tahiri kishte bërë matjen, përshkrimin dhe vlerësimin e dy dyqaneve.

As paditësja dhe as pala e tretë nuk u njoftuan nga pala e paditur lidhur me vendimin e saj për prishjen e dy dyqaneve.

Me 1 dhe 2.03.2005, Komuna i rrënoi lokalet afariste në qendër të qytetit, duke përfshirë edhe dy dyqanet në rastin e tanishëm.

Më 3.3.2005, Komuna e lëshoi një vendim për të anuluar vendimin e saj të mëparshëm me të cilin paditëses iu ishte ndarë ngastra ... për shfrytëzim të përhershëm. Paditësja ishte urdhëruar

që ta liroj ngastrën brenda afatit e cila do të paracaktohej nga organi kompetent. Ky vendim iu dërgua paditëses me 23.05.2005. Asnjë vendim nuk u lëshua lidhur me ngastrën fqinje

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “.

Neni 319.1 i LPK: “Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe ky kolegji, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Sa i përket pretendimeve se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore absolute nga neni 182 pika b) dhe d), pasi që kjo çështje nuk bënë pjesë në kompetencën e gjykatës kontestimore dhe se në këtë çështje pala paditëse ka mundur që mbrojtjen juridike ta realizojë në Procedurën Administrative, kolegji vlerëson se objekt i padisë dhe kërkesa e padisë ka qenë kompensimi i dëmit i cili ka ndodhur si pasojë e veprimeve të Komunës së Gllgovcit në territorin e kësaj komune. Bazuar në nenin 47 të LPK gjykata kompetente, është Gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi që në rastin konkret është gjykata që ka vendosur në shkallë të parë. Sa i përket pretendimeve se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje nga neni 182 pika n), është vlerësimi i kolegjit se aktgjykimi i atakuar me ankesë përmban dispozitiv të qartë, përmban arsyet mbi faktet vendimtare dhe mund të ekzekutohet.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka administruar provat e nevojshme relevante dhe pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa themelta. Gjykata e shkallës së parë sa i përket kësaj çështje ka vepruar në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara me nenin 8 të LPK.

Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale lidhur me dëmin e pësuar, përgjegjësinë lidhur me dëmin dhe detyrimin për kompensimin e dëmit,

kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovohet. Kolegji vlerëson se bazuar në të gjitha këto që u parashtruan më lartë, rezulton se, paditësja, duke pretenduar se ishte pronare e lokaleve afariste të rrënuara nga e paditura, ka interes ligjor për të parashtruar padi dhe si e tillë në këtë çështje ka legjitimitetin real aktiv. E paditura, komuna e Gllgovcit ka legjitimitetin real pasiv, pasi që në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë e që ishte e zbatueshme në vitin 2005, Neni 2.4 Komuna ka statusin e vet juridik dhe mund të paditet në gjykatë. Komuna i ka shkaktuar dëme materiale palës paditëse duke shkatërruar dyqanet e saj, bile pa e njoftuar atë për ndonjë afat për largimin vullnetar të sendeve apo se kur do të bëhej rrënimi. Komuna nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se paditësja ishte njoftuar lidhur me ekzekutimin. Paditësja kishte qenë në shfrytëzim të këtyre lokaleve në bazë të një vendimi të ligjshëm. Dëmi material që i është shkaktuar paditëses është shprehur në vlerën monetare të dëmit të shkaktuar dhe kjo humbje është llogaritur në proporcion me vlerën e objektit të ndërtuar. Kolegji vlerëson që aktgjykimi i atakuar me ankesë, gjen mbështetje në normativën e aplikueshme ligjore që është aplikuar në Kosovë në kohën e ndodhjes së dëmit dhe që janë në aplikim edhe në kohën e tanishme. Baza ligjore është e dhënë në përmbajtjen e aktgjykimit. Sipas vlerësimit të Kolegjit aktgjykimi gjen mbështetje edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Praktikën e Gjykatës në Strasburg.

Bazuar në nenin 319.1 i LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Pala e paditur në procedurën e zhvilluar nuk ka arritur të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, në tërësinë e saj nga ana e Kolegjit është vlerësuar si e pa themeltë dhe për këtë gjë edhe është refuzuar si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 765/13, me dt. 07.03.2016

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Mr.sc. Rafet Haxhaj